



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:252870
Datë: 24.09.2024
Numri i dokumentit: 06200136

Ac.nr.7678/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Arsim Hamzaj - kryetar i kolegjit, Nora Bllaca Dula e Naim Mehulli - anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve I.M., Z.M. dhe F.M., të tre nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës, me objekt të padisë vërtetimin e së drejtës së pronësisë, duke vendosur sipas ankesës së paditësve e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - departamenti i përgjithshëm, C.nr.14/09, i datës 16.08.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë **24.09.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e paditësve I.M., Z.M. dhe F.M., të tre nga Prishtina, **PRISHET** aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - departamenti i përgjithshëm, C.nr.14/09, i datës 16.08.2022 dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar C.nr.14/09, i datës 16.08.2022, e ka refuzuar propozimin e palës paditëse për vazhdimin e procedurës së ndërprerë në këtë çështje kontestuese, deri në kthimin e dokumentacionit kadastral nga Serbia sipas aktvendimit C.nr.14/09, të datës 24.11.2015.

Kundër këtij aktvendimi paditësit, në afat ligjor ka paraqitur ankesë duke e atakuar aktvendimin e goditur për shkak të *shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale*, me propozim që të prishet aktvendimi i atakuar dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e paditësvetë paditurit të tretë është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit I.M., Z.M. dhe F.M., të tre nga Prishtina, me datë 05.01.2009, kanë parashtruar padi në gjykatën e shkallës së parë, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës P.M., me objekt të padisë padisë vërtetimin e së drejtës së pronësisë, me kërkesë të përshkruar si në petitumin e kërkesëpadisë.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësve, me aktvendimin C.nr.14/09, të datës 24.11.2015, e ndërprente procedurën në këtë çështje kontestimore, për shkak të mungesës së dokumentacionit kadastral. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 278 lidhur me nenin 280.4 LPK-së, për të ndërprerë procedurën në këtë çështje kontestimore.

Pas kësaj paditësit me parashtrësën e datës 02.11.2021 gjykatës i propozojnë vazhdimin e procedurës së ndërprerë me arsyetimin se i kanë dorëzuar provat, të cilat do të dorëzohen në seancë gjyqësore.

Duke vendosur sipas këtij propozimi gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë aktvendimin e atakuar C.nr.14/09, të datës 16.08.2022, me të cilin e ka refuzuar propozimin e palës paditëse për vazhdimin e procedurës së ndërprerë në këtë çështje kontestuese, deri në kthimin e dokumentacionit kadastral nga Serbia sipas aktvendimit C.nr.14/09, të datës 24.11.2015. Në arsyetim të këtij aktvendimi gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nuk janë plotësuar kushtet për vazhdimin e procedurës së ndërprerë të përcaktuar në nenin 280 par.4 të LPK-së, pasi që pala paditëse përveç parashtrësës për vazhdimin e procedurës së ndërprerë, gjykatës nuk i ka prezantuar asnjë provë me të cilën do të vërtetohej se janë plotësuar kushtet për vazhdimin e procedurës.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe i ligjshëm pasi që aktvendimi i atakuar është përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1, lidhur me nenin 13, 278 dhe 280 të LPK-së.

Deri të shkelja e dispozitave të sipërcituara ka ardhur për arsye se gjykata e shkallës së parë i ka interpretuar dhe zbatuar gabimisht dispozitat e nenit 13, lidhur me nenin 278 dhe 280 të LPK-së. Kjo për faktin se referuar shkresave të lëndës, në rastin konkret asnjëherë nuk janë plotësuar kushtet ligjore për të ndërprerë procedurën në çështjen kontestimore të ngritur me padi nga paditësit, pasi që çështja e dokumentacionit kadastral nuk mund të konsiderohet si çështje paraprake në raport me vendosjen e padisë së paditësit të cekur më lartë. Si rrjedhojë, dispozitat ligjore në të cilat është thirrur gjykata e shkallës së parë fillimisht për ndërprerjen e kësaj procedure, edhe tani për mosvazhdimin e saj nuk e parashohin fare mundësinë që gjykata të

mund të ndërpresë procedurën në një çështje kontestimore, për shkak të mungesës së dokumentacionit kadastral.

Nga arsyet e cekura më lartë Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të sipërcituara, pasi që në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 278 dhe 280 të LPK-së, që procedura në këtë çështje kontestimore të ndërprehet për shkak të mungesës së dokumentacionit kadastral, për çka edhe aktvendimi i atakuar u deshtë të prishet dhe lënda ti kthehet në rishqyrtim dhe vendosje gjykatës së shkallës së parë.

Andaj, udhëzohet gjykata e shkallës së parë që në ri procedurë të veprojë konform vërejtjeve të cekura më lartë, pasi që në rastin konkret padia e paditësit ka të bëjë me vërtetimin e së drejtës së pronësisë, atëherë për këtë çështje të vendos duke marr për bazë dispozitat ligjore përkatëse të parapara për pronësinë, ashtu që të vazhdojë procedurën të administrojë provat e propozuara nga palët ndërgjyqëse, të vërtetoj gjendjen faktike dhe të vendos në mënyrë meritore për kërkesëpadinë e paditësve në bazë të ligjit. Sa i përket mungesës së dokumentacionit kadastral, gjykata e shkallës së parë në këtë çështje duhet të vendos në bazë të provave të parashtruara nga palët në shkresat e lëndës.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 208 dhe 209 pika (d) e LPK-së, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.7678/22, datë 24.09.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari
Arsim Hamzaj